VENDIM
Nr 86, datë 30.6.2015

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "LENGARICA & ENERGY" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 2, germa "c"; 16; 37, pika 2, germa "ç" dhe 39, pika 3, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "f"; 5 pika 1, germa "f"; 10, pika 3, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008 dhe nenit 18, pika 1, germa "a" e "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.6.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Lengarica & Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Lengarica & Energy" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrator dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Sasinë e energjisë elektrike të parashikuar për furnizimin e klientëve të kualifikuar (neni 9, pika 4/9, germa "a");
- Nivelin e tensionit dhe mënyrën e realizimit të matjes për klientët e kualifikuar (neni 9, pika 4/9, germa "b"); dhe
- Kapitalin financiar të deklaruar nga shoqëria për ushtrimin e këtij aktiviteti (neni 9, pika 4/9, germa "c") do të njoftohet subjekti që në bazë të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t'i paraqesë këto në ERE brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë "Lengarica & Energy" sh.p.k., në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti